



INTERSIG[®]

VIENNA INSURANCE GROUP

Raport
vjetor
**20
22**



Make life easy!

PËRMBAJTJA

Struktura e Intersig VIG	4	Tregu i Sigurimeve në Shqipëri - 2022	12
Organizimi i Intersig VIG	5	Intersig VIG në Tregun Shqiptar	13
Historiku i Intersig VIG	6	Tregues për vitin 2022	14
Vienna Insurance Group (VIG)	7	Menaxhimi i Riskut	15-17
Garanci për çdo risk	8	Raporti i Auditit të Brendshëm	18-20
Intersig në Shqipëri	9	Pasqyrat Financiare	21-25
Vizioni dhe Misioni i Intersig VIG	10	Plani për 2023	26
Stafi i Intersig	11	Kontakt	27

Struktura e Intersig VIG

Intersig Vienna Insurance Group operon në tregun shqiptar prej Tetorit 2001 në fushën e sigurimit të jo-jetës.

Struktura e Këshillit Mbikëqyrës

- | | |
|----------------------|---------|
| • Z. Peter Hoefinger | Kryetar |
| • Z. Christoph Rath | Anëtar |
| • Znj. Liane Hirner | Anëtare |

Struktura e Bordit Drejtues

- | | |
|---------------------|----------------------------|
| • Z. Fitnete Sulaj | Drejtoreshë e Përgjithshme |
| • Znj. Gentian Sula | Anëtar Bordi |
| • Z. Fatmir Bërdica | Anëtar Bordi |


Struktura e Aksionarëve

- | | |
|--------------------------|--------|
| • Vienna Insurance Group | 89,98% |
| • Z. Gentian Sula | 10,02% |

Shoqëri nën zotërim

Intersig VIG zotëron 50% të VIG Services Albania Shpk.

Organizimi i Intersig VIG



* Intersig VIG obtains (transferred) back office services from the company VIG Services Shqiperi, such as: Finance & Accounting; IT and Claim Handling.

** Services shared between two companies: Intersig VIG and Sigma Interlbanian, which are both part of Vienna Insurance Group.

Historiku i Intersig VIG

2001

Intersig u themelua në vitin 2001 nga një grup aksionarësh vendas të cilët morën licencën për një kompani jo-jete në Republikën e Shqipërisë.

2001 – 2011

Intersig pati një rritje të qëndrueshme në market share. Vienna Insurance Group bleu shumicën e aksioneve të Intersig Sha., në bazë të një marrëveshjeje të firmosur në 25 Gusht 2011 në Tiranë.

2011 – Sot

Aktualisht, VIG zotëron 89,98% të aksioneve të Intersig VIG, fakt që ka influencuar në përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve të ofruara.

Intersig VIG ka reformuar shumë procese duke investuar në përmirësimin e kualitetit të stafit dhe digjitalizimin e procedurave në shitjen e produkteve të sigurimit



Vienna Insurance Group (VIG)

Vienna Insurance Group, me seli të regjistruar në Vjenë, Austri, është një nga grupet më të mëdha ndërkombëtare të sigurimve në Evropën Qendrore dhe Lindore, me mbi 25,000 punonjës në 50 shoqëri të shpërndara në 30 shtete.



WE ARE **NUMBER 1**
IN CENTRAL AND EASTERN EUROPE.

Garanci për çdo risk

Nëpërmjet nënshkrimit të Marrëveshjeve të Risigurimit përsa i përket produkteve të sigurimit jo-jetë, Shoqëria INTERSIG VIG ofron për klientët e saj, në përputhje me Liçencën e Ushtrimit të Aktivitetit, garanci të plotë për çdo risk.


Marrëveshjet e Risigurimit, i mundësojnë shoqërisë transferimin e rrezikut në shoqëritë e mëdha të Risigurimit. Marrëveshjet e Risigurimit mundësohen nga VIG RE si dhe nga Risigurues të tjerë, të gjithë të vlerësuar me "A+" nga Standard & Poor's.

VIG Group vlerësohet me "A+" me një perspektivë të qëndrueshme nga Standard & Poor's (S&P), gjë që e bën Vienna Insurance Group shoqërinë më të vlerësuar në indeksin kryesor ATX të Bursës së Vjenës.

VIG Group është e listuar në Bursën e Vjenës që nga viti 1994, në Bursën e Pragës që nga viti 2008 dhe në Bursën e Budapestit që nga nëntori 2022.

VIG Re, me qendër në Pragë, Çeki, është shoqëria e risigurimit të grupit VIG, e cila mbështet të gjitha shoqëritë e grupit dhe më tej. VIG Re gjithashtu ka një vlerësim "A+" me një perspektivë të qëndrueshme nga Standard & Poor's që nga themelimi i saj në vitin 2008.

Përfshirja në marrëveshje risigurimi i mundëson shoqërisë INTERSIG VIG kapacitete më të lartë të marrjes në sigurim si dhe ofron ekspertizë të dedikuar për risqe të veçanta, duke bërë të mundur që shoqëria të leshojë polica sigurimi me limite nga më të lartat në treg, për të gjithë linjat e biznesit jo-jetë.

A large, bold, red 'A+' rating symbol is positioned in the lower right quadrant of the slide. The 'A' is significantly larger than the '+' sign, and both are rendered in a vibrant red color with a subtle drop shadow effect.

Intersig VIG në Shqipëri


Viti 2022 shenjon dhe vitin e 21-të të aktivitetit të Intersig VIG në fushën e sigurimeve në Republikën e Shqipërisë.

Zyra Qendrore e Intersig VIG gjendet në Tiranë.

Shoqëria operon në bazë të një rrjeti të gjerë të degëve, agjencive dhe pikave të shitjes.

Intersig VIG përfaqësohet në 16 rajone të Shqipërisë.

Në fund të vitit 2022, Shoqëria ka patur një numër total prej 138 punonjësish dhe 180 agjentë dhe agjensi.



Vizioni dhe Misioni i Intersig VIG

Vizioni

Të jesh pjesë e një grupi udhëheqës të sigurimeve dhe shërbimeve financiare që kërkon vazhdimisht rritje të qëndrueshme si edhe për të rritur vlerën e ndërmarrjes. Ne dëshirojmë të jemi agjensia e sigurimit e zgjedhur, e përkushtuar për edukimin, shërbimin dhe mbrojtjen e familjeve dhe bizneseve vendore me politikat më të mira dhe me çmimin e duhur. Vizioni ynë është të vendosim standardin e përsosmërisë midis ofruesve të sigurimeve duke qenë inovator, duke qenë i fortë financiarisht, duke siguruar mbështetjen dhe shërbimin e duhur për klientët tanë.

Misioni

Dedikimi për të qenë kompania lider në Shqipëri në saje të produkteve kompetitive dhe shërbimit me kualitet që ofrojmë. Përpiqemi që çdo ditë të veprojmë me integritet; kërkojmë dhe përqafojmë larminë; dëgjojmë, edukojmë dhe mësojmë; ofrojmë zgjidhje; gjenerojmë energji pozitive; dhe mbështesin komunitetin tonë. Ne ofrojmë risi dhe përsosmëri në produktet dhe shërbimet tona. Në gjithçka që bëjmë, jemi të përkushtuar të shkojmë përtej pritshmërive. Gjithmonë do të mbetemi fleksibël dhe inovues, në mënyrë që të jemi në gjendje t'i adresojmë nevojat në varësi të klientëve tanë. Ne krijojmë vlera solide. Ndergjegjshmeria për CSR, është arsyeja pse INTERSIG është angazhuar në programe sociale dhe projekte të dedikuara kryesisht personave me mundësi të kufizuara si edhe femijeve, të cilët janë e ardhmja jone.

Premtimi ynë: **Make Life Easy!**

Premtimi i VIG: **Protecting What Matters!**

Stafi i Intersig VIG

Një kujdes i veçantë i kushtohet trajnimit të vazhdueshëm të punonjësve tanë, në mënyrë që t'i ofrojmë klientëve në çdo kohë shërbimin e duhur profesional.



Stafi i Intersig VIG

Një kujdes i veçantë i kushtohet motivimit të vazhdueshëm të punonjësve tanë.
Staff Retreat



Tregu i Sigurimeve në Shqipëri - 2022


- Gjatë vitit 2022, tregu i sigurimeve në Republikën e Shqipërisë pësoi një rritje prej 9.16% krahasuar me një vit më parë. Volumi i primeve të shkruara bruto është rritur me 1,764,931 mijë lekë duke arritur vlerën 21,032,729 mijë lekë.
- Numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,325,231, me një rritje prej 12.93 % krahasuar me një vit më parë.
- Tregu mbeti i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.75 % të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 8.01%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 32.25% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 67.75% të totalit të tregut.
- Gjatë vitit 2022, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 6,830,000 lekë, ose 2.39% më shume se në vitin 2021.
- Ndërkohë dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për vitin 2022 kapën vlerën 4,445,477 lekë, duke pësuar një rritje me rreth 11.53% krahasuar me vitin 2021.

Intersig Vienna Insurance Group në Tregun Shqiptar

Gjatë vitit 2022, Intersig VIG ka shkruar rreth 1,810 milion lekë prime, duke zotëruar kështu 9.8% të tregut.


Intersig ka paguar rreth 534 milion lekë Dëme gjatë vitit 2022. Numri i kërkesave të Dëmeve të paguara nga Intersig gjatë 2022 është 9781 ose 17,56% e të gjithë kërkesave të tregut.

Primet e Shkruara Bruto
Shoqëri Sigurimi të Jo-Jetës




■ Intersig VIG ■ Të tjerë

Dëmet e paguara në Numër



■ Intersig VIG ■ Të tjerë

Dëme të paguara në Vlerë



■ Intersig VIG ■ Të tjerë

Tregues për vitin 2022

Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit	176.71%
Treguesi i Likuiditetit (31 Dhjetor 2022)	3.25
Treguesi në mbulimin e provigjioneve teknike	156.22%


Procesi i Vlerësimit të Riskut

Këto janë risqet (përfshirë dhe kategoritë e nën-risqeve) tek të cilat fokusohet dhe analiza e vetëvlerësimit.

Risku i marrjes në sigurim

Risku operacional

Risku i tregut



Vlerësimi dhe Menaxhimi i Riskut

Intersig kryen në mënyrë të rregullt vjetore procesin e vlerësimit të riskut të shoqërisë. Për këtë qëllim, është krijuar struktura e brendshme e menaxhimit të riskut të shoqërisë, e përbërë nga Departamenti i Menaxhimit të Riskut ku përfshihet Komiteti i Menaxhimit të Riskut.

Për kontrollimin dhe vlerësimin e risqeve të shoqërisë, Intersig përdor modelet e shoqërisë mëmë, Vienna Insurance Group. Risqet kryesore të shoqërisë, përveçse janë të identifikuara, kanë po ashtu të përcaktuar frekuencën dhe shkallën e rëndësisë, masat dhe kontrollet e ndërmarra për secilin risk.

1. Risket kryesore të identifikuara:

- Risku i tregut
- Risku i marrjes në sigurim të jo-jetës
- Risku i marrjes në sigurim të produktit të shëndetit
- Rreziku i mospagimit të palës
- Risku Operacional
- Risku i përputhshmërisë ligjore
- Risku i TI dhe sigurisë
- Risku i likuiditetit
- Risku i reputacionit
- Risku Strategjik etj.

Vlerësimi dhe Menaxhimi i Riskut

2. Prova e Rezistencës

Vlerësimi dhe klasifikimi i risqeve dhe kryerja e provave të rezistencës bëhet në bazë skenari dhe në bazë ndjeshmërie ndaj ngjarjes. Nga sa më sipër, kryhet llogaritja e nevojave për kapital shtesë në rast se, gjatë vitit të ardhshëm, ndodhin të gjithë skenarët e menduar të situatave katastrofike, epidemike dhe të krizave financiare.

3. Administrimi i Kapitalit dhe Niveli i Aftësisë Paguese

Intersig sigurohet që të mbajë një fond garancie jo më pak se 1/3 e marzhit të aftësisë paguese minimale, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

4. Plani i Vazhdimësisë së Aktivitetit

Intersig ka hartuar planin e vazhdueshmërisë së aktivitetit, në të cilin parashikohen skenaret e risqeve të ndryshme të mundshme si dhe masat që duhet të ndërmerren në çdo rast nga personat përgjegjës.

5. Profili i Përgjithshëm i Riskut

Intersig ka marrë masat e nevojshme për mbrojtjen nga pasojat e skenarëve të mësipërm dhe për rrjedhojë, risku i shoqërisë rezulton i menaxhueshëm.

Përmbledhje e aktivitetit të Audituesit të Brendshëm

Auditimet dhe kontrollet e kryera

INTERSIG -Përmbledhje e rezultateve të Auditimit të Brendshëm për vitin 2022

Kryerja e aktiviteteve audituese gjatë vitit 2022 në shoqëri të sigurimit Intersig VIG është bazuar në kornizën rregullatore të përbërë nga - Legjislacioni i AMF për veprimtarinë e Sigurimeve dhe Risigurimeve, Parimet kryesore të Auditimit të Brendshëm të VIG Group, Rregullore Nr.153 "Për veprimtarinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe në rregulloret e brendshme të shoqërisë.



Përmbledhje e aktivitetit të Audituesit të Brendshëm

Gjatë vitit 2022 Auditimi i Brendshëm i Shoqërisë është përqëndruar në auditimin e aktiviteteve të Shitjes, të Dëmeve, Marrja në Sigurim dhe Menaxhimi i Riskut, Administrimit financiar & Kontabiliteti, Risigurimeve dhe Teknologjisë së Informacionit. Bazuar në strukturën organizative të shoqërisë auditimet e kryera janë bërë duke përfshirë departamentet në zyrat qendrore, dhe në degët për agjentet e shoqërisë dhe të ndërmjetësve të tjerë të shitjes, kjo me qëllimin për të mbuluar plotësisht të gjitha fushat e veprimtarisë së shoqërisë bazuar në temat e auditimit sipas aktiviteteve të miratuara në Planin e Auditimit të Brendshëm për vitin 2022

Përmbledhje e aktivitetit të Audituesit të Brendshëm

Aktivitetet e Shitjes: Aktiviteti i shitjes së produkteve të licensuara te shoqërise drejtohen nga Departamenti i Shitjeve në zyrat Qendrore te shoqërise i cili menaxhon te gjitha shitjet e shoqërise që bëhen në degët e shoqërise të Agjentëve dhe të ndërmjetësve të tjerë të licensuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare. Kontrollat e Auditit te Brendshëm për vitin 2022 në aktivitetet e shitjes janë fokusuar në zbatimin e kërkesave ligjore të AMF, të zbatimit të rregulloreve të brëndshme te shoqërisë, për regjistrimin e sakte dhe pa vonesa te policave te sigurimit ne programin e shitjes MBA ,në arkëtimin e primeve vecanërisht për produktet vullnetare, Gjate vitit 2022 janë kryer kontrole për zbatimin e Rregulloreve dhe udhëzimeve të Bordit Drejtues shoqërise Intersig, lidhur me llogaritjet dhe menaxhimin e komisioneve te shitjes, si dhe regjistrimin e tyre ne programin e shitjes së policave.

Kontrolli i shitjes së policave të produkteve TPL, Karton Jeshil dhe Kufitare në qënder dhe në degët e shoqërisë jane kryere lidhur me kohen e regjistrimit dhe të shitjes së polices ne programin shitjes, si dhe të risqeve që këto polica mbartin. Kontrolli lidhur me saktësisë se plotësimit me të dhëna te këtyre policave për kategorinë e mjetit, dhe të dhenave të tjera të kërkuara sipas rregullores së administrimit e menaxhimit të shitjeve për vitin 2022

Përmbledhje e aktivitetit të Audituesit të Brendshëm

Aktivitetet e Trajtimit të dëmeve. Meqënëse funksionet e trajtimit të dëmeve për dy shoqëritë Intersig VIG, dhe SigmaInteralbanian VIG janë të transferuara në kompaninë e shërbimit **“Vig Services Shqiperi”**. Kontrollat në Departamentin Trajtimit të Dëmeve janë kryer lidhur me menaxhimin dhe trajtimin e dëmeve bazuar në zbatimin e Legjislacionit në fuqi për tregun e sigurimeve, bazuar në zbatimin e Rregulloreve e udhëzimeve të AMF-se, si dhe në zbatimin rregullorë e udhëzimeve të dhëna nga shoqëria Intersig VIG. Kontrollat janë kryer duke mbuluar pothuajse të gjitha produktet e dëmeve sipas klasave të sigurimit për dëmet materiale dhe jo-materiale të vitit 2022. Për trajtimin e dëmeve kontrollat janë fokusuar në proceset për ekspertimin dhe vlerësimin e dëmeve bazuar në kërkesat rregullatore të AMF-se. Janë kontrolluar kohëzgjatja e trajtimit të dëmeve, si dhe zbatimi i afateve ligjore për pagesën e dëmshpërblimit për klientet bazuar në kërkesat dhe rregulloret e AMF-se si dhe në rregulloren e brendshme të departamentit dëmeve VIG. Services. Janë kryer kontrolle për problematikat lidhur me funksionin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit informatik MBA të trajtimit të dëmeve.

Aktiviteti I Administrimit Financiar të primeve, dhe të Kontabilitetit & Raportimit Financiar.

Përmbledhje e aktivitetit të Audituesit të Brendshëm

Aktiviteti I Administrimit Financiar te primeve, dhe te Kontabilitetit & Raportimit Financiar

Departamenti i Administrimit financiar e kryen veprimtarine e vetë në zyrat e qendrore të kompanise Intersig VIG, kurse departamenti i Kontabilitetit dhe Raportimit financiar të shoqërisë e kryen veprimtarinë e tij në kompanine e shërbimit VIG Services. Për vitin 2022 kontrollet në departamentin e Administrimit Financiar janë fokusuar në administrimin e policave për të gjitha proceset që kalon policat e sigurimit në programin MBA, pasi policat rregjistrohen nga departamenti i shitjes si dhe nga agjentet ,zyrat dhe ndërmjetesit e tjerë të shitjes deri në arkëtimin e primeve dhe në rakordimet përkatëse. Temat kryesore të kontrolluara për vitin 2022 kanë qene ,raportet në nivel police dhe agjenti, për menaxhimin e primeve , arketimit të primeve, te debitoreve , te inventarit fizik dhe ate të rregjistruar në programin MBA për administrimin të policave të sigurimit. Janë kryer kontrole lidhur me llogaritjen e komisioneve në përputhje me urdhrat e brendshme të Bordit te Drejtoreve te shoqërisë si dhe ne zbatimin e procedurave per leshimin e policave dublikate dhe te policavete anuluar. Kontrole jane ushtruar edhe me rakordimet nga ana e departamentit me agjentet, degët dhe ndërmjetesit e tjere të shitjes lidhur me primet e policave të shitura, me arketimin e primeve, me debitoret e tjera.

Në departamentin e Kontabilitetit në Vig Services kontrollet janë fokusuar lidhur me saktësinë e regjistrimeve në programin SAP, të primeve te shkruara, të primeve të arketuara, dhe të balancave të hapura debitore për primet e pa arketuara, ne nivel kompanie, degeve, agjenteve e ndërmjetësve të tjerë të shitjes. Janë kontrolluar rakordimet mujore dhe vjetore te cillat kryen nga departamenti i Kontabilitetit dhe raportimit financiar VIG Services, me departamentin e Administrimit në shoqerine Intersig rakordimi kryhet për krahasimin e të dhënave dhe treguesve të raportuara në programin SAP me të dhënat dhe treguesit e raportuara në programin MBA. Nga kontolli ka rezultuar se të dhënat janë korrekte dhe të nenshkruara nga personat përgjegjës për të dyja palët.

Përmbledhje e aktivitetit të Audituesit të Brendshëm

Aktivitetet e Marrjes ne Sigurim dhe të Menaxhimit të Riskut

Aktiviteti për këto dy departamente është bërë kryesisht me marrjen në sigurim të produkteve vullnetare si për Pronat, Përgjegjësi, Garancië e tjera, Gjatë marrjes në sigurim janë kryer kontrollet lidhur me të dhënat dhe analizen e klientit dhe me përshkrimin dhe analizën e pronës, si dhe të treguesve të tjerë të marrjes në sigurim si dhe të përcaktimit të rrisqeve për cdo produkt, pronë përgjegjësi e të tjera për cdo kontratë sigurimi të caktuar. Kontrollet janë kryer edhe lidhur me plotësimin e formularëve dhe të dokumentacionit të marrjes në sigurim, si dhe me regjistrimin apo plotësimin në programin MBA të dokumentave kryesore të marrjes në sigurim bazuar në rregulloren e brendshme të marrjes në sigurim,

Analizat, vlerësimi dhe menaxhimi i riskut kryhet nga Komiteti i Menaxhimit të riskut. Për cdo rast sigurimi sipas limiteve të shumës së marrjes në sigurim dhe të nivelit të miratimit Komiteti i Menaxhimit të riskut, bën vlerësimin e riskut dhe përgatit ofertat për vlerën e primit të marrjes në sigurim, bazuar në rregulloret e brendshme dhe në urdhërat e udhëzimet e Bordit Drejtues të shoqërisë.

Përmbledhje e aktivitetit të Audituesit të Brendshëm

Departamenti i Risigurimeve

Departamenti i Risigurimeve kryhen funksionet e tij të shërbimit për dy shoqërite e sigurimit Intersig VIG dhe Sigma InterAlbanian VIG. Partneri kryesor i shoqërisë për aktivitetin e risigurimeve është VIG-RE i cili është pjesë e Vienna Insurance Group. Veprimtaria dhe proceset e punës që kryhen nga ky departamentet janë të rregulluara, bazuar Ligjin Nr. 52, datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", të AMF-se. bazuar në politikat dhe rregulloren e Grupit VIG Departamenti i Risigurimeve ka për objekt kryerjen e risigurimeve të shoqërisë Intersig VIG si dhe përgatitjen e raporteve për lidhjen e marrëveshjeve të risigurimit, në kontrollin e kushteve të kontratave të Risigurimit bën harmonizimet e këtyre kushteve me kërkesat e tregut Lokal në Shqipëri.

Temat e kontrollit për vitin 2022 janë kryesisht për Miratimin e limitit të cmimeve të risigurimeve për kompanite e grupit ku bën pjesë edhe shoqëria Intersig , si dhe të Risigurueseve -Jashtë Security Liste Kontrolle të marrëveshjeve të risigurimeve Fakultative dhe Fronting.

Përmbledhje e aktivitetit të Audituesit të Brendshëm

Departamenti Ligjor

Kontrollet e kryera nga Auditi i Brendshëm në aktivitetet juridike të shoqërisë gjatë vitit 2022 janë fokusuar në perfaqësimin dhe mbrojtjen e shoqërisë në proceset gjyqësore me palët e treta lidhur me trajtimin e dëmeve, pasurore dhe jo-pasurore, si dhe ato të fondit të kompensimit. Gjithashtu gjatë viti 2022 kontrollet janë bërë lidhur me zgjidhjen me Marrëveshje të problemeve me klientë të ndryshëm, ku janë eliminuar shkuarja në gjykatë dhe zgjidhen me proces Gjyqësor të çështjeve. Gjithashtu pjesë e aktiviteteve juridike të shoqërisë janë ndjekja dhe mbështetja për grumbullimin primeve të paarkëtuara nga klientët dhe subjektet debitore

Opiniononi i shkurtuar i Auditit te Brendshëm per vitin 2022


Auditimet dhe kontrollet e brëndshme të realizuara gjatë vitit 2022 kanë mbuluar të gjitha aktivitetet e shoqërisë në përputhje me planin vjetor të auditimit. Angazhimet audituese janë finalizuar me gjetjet dhe rekomandimet perkatese, të cilat janë pasqyruar në raportet e auditimit të dërguara në Bordin Drejtues të shoqërisë INTERSIG VIG, dhe në mënyre të përmbledhur në Këshillin Mbikqyres të saj.

Në mënyre të vazhdueshme Departamenti i Auditit të Brendshëm ka monitoruar dhe dokumentuar realizimin e rekomandimeve të miratuara si dhe statusin përfundimtar te realizimit të tyre.

Bazuar në rezultatet e auditimeve të kryera gjatë vitit, Auditi i Brendshëm shpreh siguri të arsyeshme që aktivitetet e shoqërisë INTERSIG VIG gjate vitit 2022 janë kryer në përputhje të plotë me kuadrin ligjor për tregun e sigurimeve në Shqipëri.

Theksojmë se në angazhimet tona audituese gjate vitit 2022 **nuk** janë evidentuar gjetje kritike ose gabime materiale, te cilat te kene nje impakt domethënes në aktivitetin e shoqërisë.

Opinion i Shoqërisë Audituese



Ernst & Young Certified Auditors
Albania Branch
NUIIS: K619110121
Ibrahim Rugova Str, Sky Tower, 6th floor
1001, Tirana, Albania

Tel: +35542419575
ey.com

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët e Intersig Vienna Insurance Group sh.a.

Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Intersig Vienna Insurance Group sh.a (më poshtë "Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2022, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2022, dhe performancën financiare dhe flukseve të parasë për vitin e mbyllur më atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të").

Baza për opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin *Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare* të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) ("Kodi i BSNEPK") dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë ("Kodi IEKA"), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", të ndryshuar, që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK dhe Kodin IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të Tjera të Përfshira në Raportin Vjetor 2022 të Intersig Vienna Insurance Group sh.a.

Informacione të tjera përfshijnë informacione në raportin vjetor të Shoqërisë për vitin 2022, përgatitur në përputhje me nenet 17 dhe 19 të Ligjit Nr. 25\2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti vjetor i Shoqërisë për vitin 2022 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lartë kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në të një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Intersig Vienna Insurance Group sh.a, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Raportet për agjensitë rregullatore - kërkesa e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Republikës së Shqipërisë për marzhin e Aftësisë Paguese dhe Aktiveve në Mbulim të Rezervave Teknike.

Në përputhje me kërkesat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, ne kemi lexuar skedulet suplementare shoqëruese të marzhit të Aftësisë Paguese dhe Aktiveve në Mbulim të Rezervave Teknike. Këto Skedula Suplementare të përgatitura nga Drejtimi nuk janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare Shoqërisë. Informacioni financiar historik, prezantuar në Skedulet Suplementare shoqëruese të marzhit të Aftësisë Paguese dhe Aktiveve në Mbulim të Rezervave Teknike përgatitur nga Drejtimi, është konsistent, në të gjitha aspektet materiale, me informacionin financiar vjetor të paraqitur në pasqyrat financiare të Shoqërisë më datë 31 dhjetor 2022.

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e Skedulave Suplementare shoqëruese të marzhit të Aftësisë Paguese dhe Aktiveve në Mbulim të Rezervave Teknike, në përputhje me Ligjin nr. 52/2014 "Mbi veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega në Shqipëri

Ernst & Young
30 mars 2023
Tiranë, Shqipëri



Mario Vangjel
Auditues Ligjor

Pasqyrat Financiare

Pasqyrat Financiare sipas Standardeve
Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe Skedulet
Suplementare më 31 dhjetor 2022

Intersig Vienna Insurance Group sh.a.

Pasqyra e pozicionit financiar

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

Shënimi	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
AKTIVET		
Aktive të trupëzuara	9 260,418	272,692
Aktive të patrupëzuara	10 12,474	10,566
Aktive me të drejtë përdorimi	11 33,183	39,174
Aktive të mbajtura për investime	12 153,979	162,083
Aksione në shoqëri të lidhura	13 24,601	18,454
Aktive të risigurimit	14 986,646	939,133
Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim	15 1,227,801	1,093,139
Depozita me afat me banka	16 868,679	803,661
Aktive të tjera	17 72,861	76,345
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	18 202,488	252,377
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	19 84,979	81,541
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	20 155,021	108,827
TOTALI I AKTIVEVE	4,083,130	3,857,992
KAPITALI		
Kapitali aksionar	21 417,471	417,471
Rezerva e rrezikut të sigurimit	21 41,747	41,747
Fitime të mbartura	374,053	341,457
TOTALI I KAPITALIT	833,271	800,675
DETYRIMET		
Detyrime për kontratat e sigurimit	22 1,379,435	1,267,258
Rezerva për primet e pafituara	23 894,930	888,660
Depozitë e risiguresit	24 801,993	727,822
Detyrime për qira	11 33,164	39,629
Detyrime tatimore dhe të tjera	25 25,216	22,917
Tatim fitimi i pagueshëm	37 4,065	1,982
Llogari të pagueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	26 111,056	109,049
TOTALI I DETYRIMEVE	3,249,859	3,057,317
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	4,083,130	3,857,992

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i shoqërisë më datë 27 Mars 2023 dhe nënshkruar në emër të tyre nga:


Fitnete Sulaj
Intersig Vienna Insurance Group sh.a. PËR GJITHSHËNIMET


Ilir Elmazri
Vite Service SH.P.K.



Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 44, që janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

Intersig Vienna Insurance Group sh.a.

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

Shënimi	2022	2021
Prime të shkruara bruto	27 1,810,857	1,744,173
Ndryshimi në rezervën për primet e pafituara	23 (6,271)	(50,639)
Të ardhura nga primi i sigurimit	1,804,586	1,693,534
Prime të ceduara të risiguresit	28 (783,248)	(725,661)
Ndryshimi në rezervën e risiguresit për primet e pafituara	23 15,326	(27,136)
Prime të ceduara të risiguresit	(767,922)	(752,797)
Prime të fituara neto	1,036,664	940,737
Të ardhura nga komisionet e risigurimit	29 375,017	330,602
Të ardhura nga investimet	30 65,332	63,321
Të ardhura të tjera	31 17,486	14,436
Të ardhura të tjera	457,835	408,359
Të ardhura totale	1,494,499	1,349,096
Ndryshimi në rezervën e dëmeve bruto	22 (112,177)	32,970
Ndryshimi në rezervën e dëmeve të risiguresit	22 32,187	(32,247)
Dëme të paguara, bruto	22 (561,329)	(681,570)
Dëme të paguara nga risiguresi	22 198,466	327,301
Dëme të sigurimit, neto	(442,853)	(353,546)
Shpenzimet e marrjes në sigurim	32 (496,509)	(516,695)
Shpenzime administrative	33 (354,625)	(314,951)
Shpenzime të tjera nga aktiviteti i sigurimit	34 (34,896)	(35,483)
Shpenzimet	(886,030)	(867,129)
Shpenzime financiare	35 (13,360)	(11,246)
Humbje nga kurset e këmbimit, neto	36 (17,998)	(5,348)
Shpenzime të tjera	(31,358)	(16,594)
Fitimi para tatimit	134,258	111,827
Tatimi mbi fitimin	37 (23,948)	(20,399)
Fitimi i vitit	110,310	91,428
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin, neto nga taksat	-	-
Totalii i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	110,310	91,428

	Kapitali aksionar	Rezerva	Fitime të mbartura	Totali
Gjendja më 1 janar 2021	417,471	41,747	293,500	752,718
Fitimi i vitit	-	-	91,428	91,428
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse të vitit, neto nga taksat	-	-	-	-
Totalii i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-	91,428	91,428
Transaksioni me pronarët, i regjistruar direkt në kapital				
Shpërndarje dividend (shënimi 21)	-	-	(43,471)	(43,471)
Kontributet totale nga dhe shpërndarja tek pronarët	-	-	47,957	47,957
Gjendja më 31 dhjetor 2021	417,471	41,747	341,457	800,675
Fitimi i vitit	-	-	110,310	110,310
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse të vitit, neto nga taksat	-	-	-	-
Totalii i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-	110,310	110,310
Transaksioni me pronarët, i regjistruar direkt në kapital				
Shpërndarje dividend (shënimi 21)	-	-	(77,714)	(77,714)
Kontributet totale nga dhe shpërndarja tek pronarët	-	-	32,597	32,597
Gjendja më 31 dhjetor 2022	417,471	41,747	374,053	833,271

	Shënimi	2022	2021
Fitimi para tatimit		134,258	111,827
Flukset monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit			
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlërësimin dhe amortizimin	34	51,630	54,939
Fshirje/Pakësime		-	-
Humbje nga zhvlërësimi i llogarive të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit	20	6,000	8,795
Shpenzime interesi	36	8,710	5,529
Të ardhura nga investimet	32	(65,332)	(63,322)
Flukset monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit para ndryshimeve në aktivitet dhe detyrimet e shfrytëzimit		135,266	112,239
Ndryshime në aktive të risigurimit		(47,513)	59,382
Ndryshime në aktive të tjera		3,484	(12,078)
Ndryshime në shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim		49,889	(20,810)
Ndryshime në llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera		(9,438)	1,012
Ndryshime në detyrime të kontratave të sigurimeve		112,177	(32,970)
Ndryshime në rezervën e primit të paguar		6,271	50,639
Ndryshime në depozitën e risiguruesit		74,171	51,606
Ndryshime në detyrime tatimore dhe të tjera		2,299	(4,125)
Ndryshime në llogari të pagueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera		2,006	7,815
Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet e shfrytëzimit		193,346	100,471
Interes i marrë		81,709	41,981
Interes i paguar		(8,710)	
Tatimi mbi fitimin i paguar		(21,865)	(20,845)
Flukset monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		379,746	233,846
Flukset monetare nga aktivitetet investuese			
Blerje aktivesh të trupëzuara	10	(11,036)	(5,067)
Blerje aktivesh të patrupëzuara	11	(5,035)	(955)
Blerje e letrave me vlerë	16	(133,353)	(114,224)
Letra me vlerë të maturuara	16	-	-
Ulje/(Rritje) në depozitat me afat		(82,971)	(64,687)
Aksione në shoqëritë e lidhura		(6,147)	-
Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet investuese		(238,542)	(184,933)
Flukset monetare nga aktivitetet finacuese			
Pagesat e qirave	12	(17,296)	(18,029)
Pagesat e dividendit		(77,714)	(41,118)
Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet finacuese		(95,010)	(59,147)
Rritja neto nga mjetet monetare dhe ekuivalentet me to		46,194	(10,234)
Mjetet monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit		108,827	119,061
Mjetet monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit	21	155,021	108,827

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 44, që janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

Objektivat 2023

Primet e shkruara bruto Plani 2023	
Produkti	Grand Total
TPL	1,150,000,000
Kartoni jeshil	218,000,000
Kufitare	63,000,000
Kasko	75,000,000
Aksidente Personale	30,000,000
Sigurim Prone	150,000,000
Sigurim Pergjegjesie	40,000,000
Sigurim Garancie	28,000,000
Mall ne Transport	5,000,000
Shendet ne udhetim	12,500,000
Sigurim Shendeti	120,000,000
Rail vehicle casco insurance	500,000
Pergjegejsi Avion	14,000,000
Kasko Avion	28,000,000
Pergjegejsi Anije	3,000,000
Kasko Anije	3,000,000
Grand Total	1,940,000,000

make life easy

KONTAKT

Dega Qendrore

Adresa: Rruga "Ismail Qemali", Samos Tower,
Kati i 2-të, Ish-Bllok, Tirane.

Tel: +355 (0) 4 22 70 576

E-mail: info@intersig.al